

**ALVIN SARAÇI**

Instituti i Historisë/Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë  
saracialvin@hotmail.com

**FEJA DHE ATDHEU NË KUVENDIN E ARBRIT: KONTRIBUTI I PAPË KLEMENTIT XI, PROPAGANDËS FIDE DHE VINÇENC ZMAJEVIQIT****Abstrakt:**

*Artikulli trajton Kuvendin e Arbrit që u mbajt më 1703 dhe kontributin e Papës me origjinë shqiptare Klementi XI - Albani (1700-1721) dhe Vinçenc Zmajeviqit për organizimin e tij dhe miratimin e dekreteve për Kishën Katolike Shqiptare e çështjen kombëtare të përhapjes së dritës së dijes dhe gjuhës e kulturës shqiptare me anë të shkollave. Botimi i dekreteve të Kuvendit të Arbrit në shqip më 1706, shërbeu si baza e së drejtës kishtare dhe si një nga tekstat e para të shqipes së bashku me gramatikën e parë shqipe për arsimimin në kolegje. Rizgjimi kulturor që i parapriu Rilindjes Kombëtare, i nisur nga Papë Klementi XI, vazhdoi me Papë Klementin XII, Corsini (1730-1740), i cili hapi Kolegjin arbëresh të San Benedetto Ullanos në Kozencë dhe të Palermos në Sicili dhe Benedikti XIV (1740-1758) i cili rikonfirmoi këto dekrete.*

**Fjalë kyçe:**

Kuvendi i Arbrit, Papë Klementi XI, Vinçenc Zmajeviqi, Propaganda Fide, dekrete, shkolla.

Kontributi i Papës me origjinë shqiptare Gianfrancesco Albani, Klementi XI për vendin e të parëve dhe rrënjët e thella shqiptare u reflektuan në dy drejtime kryesore: 1. Mbështetja nga ana e tij e projektit për hartimin e enciklopedisë *Illyricum Sacrum*, e cila përfshinte të gjithë trashëgiminë e historisë kishtare dhe civile të Shqipërisë nga epoka ilire dhe arbërore deri në fund të shek. XVIII; 2. Kuvendi i Arbrit që u mbajt në vitin 1703, ku u miratuan dekretet e kishës shqiptare dhe u diskutua

për ruajtjen e përhapjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare me anë të shkollave si ndihmesë për çështjen shqiptare.<sup>1</sup>

Papë Albani i dha jetë asaj që disa studiues arbëreshë e kanë quajtur rilindja arbëreshe, e cila sipas tyre ka paraprirë Rilindjen Kombëtare, fillimet e së cilës nisin në vitet tridhjetë të Shtatëqindës me ngritjen e seminareve italo-shqiptare të Kalabrisë (1732) dhe Sicilisë (1734).<sup>2</sup> Për këtë luajtën një rol kryesor Papë Lorenzo Corsini - Klementi XII, (1730-1740)<sup>3</sup> dhe arbëreshët përkatësisht Stefan Rodotà, i cili i propozoi Klementit XI në vitin 1717 hapjen e Kolegjit të Shën Adrianit në Shën Benedikt Ulano të Kozencës dhe Gjergj Guxeta (Giorgio Guzzeta), i cili kontribuoi për hapjen e Kolegjit të Palermos në Sicili.<sup>4</sup>

Në fakt, Rilindja Albani është më tepër një rizgjim kulturor dhe kombëtar ndërmjet dy brigjeve: i komuniteteve arbëreshe në Itali dhe i Shqipërisë. Ky proces nisi me Koncilin e Trentos (1545-1563) nën dritën e të cilit u ndërmorën një sërë reformash në gjirin e kishës katolike në kuadër të kundërreformës. Kështu, u ngritën në Romë një sërë kolegjeshe me bazë kombëtare dhe kongregacionesh administruese kishtarë.<sup>5</sup> Nisi përkthimi i teksteve liturgjike në gjuhën amtare, çka ndikoi gjithashtu pozitivisht për shqipërimin e tyre.<sup>6</sup> Shumë vite më pas, në relacionin e tij

<sup>1</sup> Simon Reboulet, *Histoire de Clement XI* (Avignon: Claude Delorme et Francois, 1752); Engjëll Sedaj, *Papa shqiptar Klementi XI – Albani dhe Kuvendi i Arbërit* (Prishtinë: Gjon Buzuku, 1998); Eqrem Zenelaj, *Gjenealogjia e familjes shqiptare Albani nga Urbino dhe Bergamo e Italisë – Papës Klementi XI – Albani* (Prishtinë: Faik Konica, 2009); Alvin Saraçi, “Le origini albanesi di un papa: Clemente XI Albani”, *Notiziario dell’Associazione Nobiliare Regionale Veneta*, Nuova Serie, Anno II, nr. 2 (Venezia: La Musa Talia, 2010), 133-144.

<sup>2</sup> Francesco Altimari, “La “rinascita” albanica e il retroterra culturale e spirituale dell’opera di padre Giorgio Guzzetta”, në *Oriente Cristiano, Venerabile Giorgio Guzzetta*, anno LV, ns, nr. 1 (Piana degli Albanesi: Quadrimestrali dell’Eparchia di Pianna degli Albanesi, gennaio-aprile 2022), 67-68, 72-73.

<sup>3</sup> Alberto Caracciolo, “Clemente XII”, *Enciclopedia dei Papi* (Roma: Istituto della Enciclopedia Italiana Giovanni Treccani, 2000), vol. III, 439-446. Lorenzo Corsini iu dha titulli i kardinalit nga Papa Klementi XI më 1706 dhe për nder të tij u quajt Klementi XII.

<sup>4</sup> Attilio Vaccaro, “Il pontificio collegio Corsini: presidio di civiltà e ortodossia per gli albanesi di Calabria”, *Hylli i Dritës*, viti XXVIII, nr. 3, (258) (Shkodër: 2008), 174-177; F. Altimari, “La “rinascita” albanica...”, 83-84.

<sup>5</sup> Guilday Peter, “The Sacred Congregation of Propaganda Fide (1622-1922)”, *The Catholic Historical Review*, vol. VI, nr. 4 (janar, 1921), 478-479.

<sup>6</sup> Zef Chiaramonte, “Çështja e gjuhëve amtare në shërbesën e shenjtë. Meshari i Gjon Buzukut (1555) në kontekstin e Koncilit të Trentos (1545-1563)”, *Seminari XXXIV*

Frang Bardhi, ipeshkëv i Sapës shkruante më 8 shkurt 1637 se i kishte përkthyer në shqip dekretet e Koncilit dhe profesionin e fesë.<sup>7</sup>

Në vitin 1622 u ngrit Kongregacioni i Propagandës Fide (Kongregacioni për përhapjen e fesë), sot Dikasteri i Ungjillëzimit, i cili bazohej te misionarët, Shtypshkronja Shumëgjuhëshe më 1726 që botonte libra edhe në shqip dhe Kolegji Urban për përgatitjen e klerit më 1627.<sup>8</sup> Studenti i parë shqiptar në Kolegjin Urban u regjistrua në vitin 1633 dhe misioni në Shqipëri u hap në gusht të vitit 1634 me ardhjen e etërve françeskanë Bonaventura da Palazzolo dhe Cherubino.<sup>9</sup>

Megjithatë, zanafilla e saj fillon me *Congregatio de rebus Graecorum* (Kongregacioni për çështjet e grekëve) i vitit 1573 për kishat e Lindjes, i cili më 1599 mori emrin *Congregatio super negotiis sanctae Fidei et religionis catholicae* (Kongregacioni për çështjet e besimit të shenjtë dhe fesë katolike).<sup>10</sup>

Që me krijimin e saj, arbëreshët të cilët i përkisnin ritit lindor bizantin kërkuan ngritjen e një seminari për përgatitjen e klerit. Kolegji u hap në Romë më 1577 dhe u quajt Kolegji i Shën Atanasit.<sup>11</sup> Këtu

---

ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (Prishtinë: Fakulteti i Filologjisë - Prishtinë, Fakulteti i Histori-Filologjisë - Tiranë, 2015), 52, 54-56.

<sup>7</sup> *Relazione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shek. XVII, Burime e materiale (1634-1650)*, përktheu dhe përgatiti për botim Injac Zamputi, vol. II (Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1963), dok. 40, f. 53-55.

<sup>8</sup> Giovanni Pizzorusso, "I Satelliti della Propaganda Fide: il Collegio Urbano e la tipografia poliglotta. Note di ricerca su due istituzioni culturali romane nel XVII secolo", *La culture scientifique à Rome à l'époque moderne. Pouvoir local et factions (XVe-XIX siècle)* (Roma: Mélanges de l'École française de Rome, 2004), 473-476; P. Guilday, "The Sacred Congregation...", 483-485.

<sup>9</sup> G. Pizzorusso, "I Satelliti della Propaganda Fide...", 476; Lucia Nadin, "Santa pazzia" francescana nell'Albania del secolo XVII", *Palaver*, 11, 2022, nr. 2, (Salerno: 2022), 5-89, në <http://siba-ese.unisalento.it> (shikuar më 22 nëntor 2022); *Viaggiatori ecclesiastici italiani in Albania nel XVII secolo*, ed. Artan Fida (Lecce: botime digjitale CISVA, 2009), IV-V, 5-89. Pas miratimit të dekretit të 22 qershorit të vitit 1634 të Propagandës Fide nga Papa Urbani VIII, u vendos ardhja e misionarëve françeskanë në Shqipëri.

<sup>10</sup> Michael Vattappalam, *The Congregation for the Eastern Churches: origins and competence* (Città del Vaticano: Libreria editrice Vaticana, 1999), 13, 27-32.

<sup>11</sup> Cesare Sanctus, "Tra la chiesa di Sant'Atanasio e il Sant'Uffizio", note sulla presenza greca a Roma in età moderna", *Chiese e nazioni a Roma: dalla Scandinavia ai Balcani. Secoli XV-XVIII*, (Roma: Istituto Balassi, Accademia d'Ungheria in Roma, Viella, 2017), 195-199.

arsimoheshin seminaristë arbëreshë dhe shqiptarë.<sup>12</sup> Në vitin 1624, Propaganda Fide pati kërkesa për ngritjen e një shkolle në Shqipëri. Në lidhje me këtë, Gjergj Bardhi, ipeshkëv i Sapës i drejtohej asaj dhe i shkruante se me shpenzimet për arsimimin e katër nxënësve në Romë, ai mund të kontribuonte për shkollimin e dhjetë të tillëve në Shqipëri.<sup>13</sup>

Në arealin e kulturës ballkanike renditen edhe misionarët shqiptarë, italianë, kroatë e boshnjakë, ndër të cilët një vend të veçantë zuri Urdhri Françeskan kryesisht për kultivimin e një vetëdije kombëtare e fetare.<sup>14</sup> Brenda këtij organizmi kishtar, promovohet pa dallim kultura e këtyre vendeve. Kështu, pati misionarë italianë dhe sllavë të cilët dhanë kontributin e tyre për kultivimin e identitetit, kulturës dhe gjuhës shqipe. Ndër ta renditet edhe Vinçenc Zmajeviq (Visko Zmajević),<sup>15</sup> i cili ishte formuar në Kolegjin Urban, ku jepte mësim në katedrën e filozofiteologjisë ashtu si ungji i tij Andrea Zmajeviq (Andrija Zmajević), argjipeshkëv i Tivarit në vitet 1671-1696.

U krijua një terren i favorshëm për marrëdhënie të ngushta ndërmjet Gianfrancesco Albanit dhe Propagandës Fide, i cili i promovoi edhe më tepër misionarët në Shqipëri dhe përgatitjen e tyre në Kolegjin Urban.<sup>16</sup> Ai dha dy bursa studimi për dy seminaristë shqiptarë, të cilët mund të ndiqnin studimet në këtë kolegji në vitin 1700, të cilëve iu shtua edhe një

<sup>12</sup> Po aty, 209.

<sup>13</sup> *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore e të Mesme në shek. XVII, Burime e materiale (1610–1634)*, përkth. dhe përgat. për botim Injac Zamputi, vol. I (Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1963), dok. 18, 13 tetor 1624, 347-349.

<sup>14</sup> Petar Vrankić, “Aktiviteti misionar në Shqipëri nën dritën e sinodeve plenare të shekujve XVIII dhe XIX”, *Shejzat – Pleiades*, nr. 1-2 (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, janar-qershor 2016), 69-70.

<sup>15</sup> Për Vinçenc ose Visko Zmajević (1670-1745) shih: Albert Ramaj, “Relacioni i Vincenc Zmajević i vitit 1702\3 dhe rëndësia e tij për shqiptarët”, në Vincenzo Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë – Relazione dello Stato d’Albania e Serbia (1702-1703)*, ed. Albert Ramaj, Peter Bartl, Injac Zamputti (St. Gallen: Albanisches Institut, Prishtinë: Faik Konica, 2022), 15-19; Peter Bartl, “Zur Biographie Vinzenz Zmajević”, në *Aus dem Briefwechsel des Erzbischofs Vincenz Zmajevich, Quellen und Materialien zur albanesischen Geschichte im 17 und 18 Jahrhundert*, ed. Peter Bartl (Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 1975), (*Albanische Forschungen*, vol. XV, ed. Georg Stadtmüller), vol. I, 9-19; Simeone Gljubic (Šime Ljubić), *Dizionario degli uomini illustri della Dalmazia* (Vienna: Rod. Lechner, Zara, Battara e Abelich, 1856), 321-322.

<sup>16</sup> F. Altimari, “La “rinascita” albanica...”, 69-70.

tjetër në vitin 1708, me anë të një fondi prej 4 000 skudësh, që u ligjërua me anë të kushtetutës *Cum in iis* të 21 qershorit 1708.<sup>17</sup> Në vitin 1717, Papë Klementi XI themeloi një organizëm autonom brenda Propagandës të quajtur «Congregatio super correctione librorum Ecclesiae orientalis» (Kongregacionin për redaktimin e librave të kishave të Lindjes), i cili përbëhej nga 5 kardinalë dhe 1 prefekt dhe merrej me tekstet liturgjike.<sup>18</sup>

Pas zgjedhjes së tij, Papë Albani u interesua për Shqipërinë dhe gjendjen e kishës katolike. Më 18 prill 1701, ai e ngriti Vinçenc Zmajeviqin në rangun e argjipeshkvit të Tivarit (1701-1713), që asokohe mbante primatin e kishës shqiptare. Për këtë duhet të ketë ndikuar kontributi i tij familjar, kontaktet e Zmajeviqit me disa nga figurat e Propagandës Fide, që kishin lidhje të ngushta me papën me origjinë shqiptare dhe mbështetja e Venecies meqenëse Perasti ishte pjesë e Kotorrit venecian. Këtë e dëshmon letërkëmbimi ndërmjet Vinçenc Zmajeviqit dhe Propagandës Fide, që është mbledhur dhe studiuar nga Peter Bartl dhe relacioni i tij pas vizitës apostolike në Shqipëri, i përkthyer nga Injac Zamputti si dokumente që hedhin dritë mbi Kuvendin e Arbrit.<sup>19</sup> Këtu mund të përmendim profesorin e Zmajeviqit në Kolegjin Urban të Kongregacionit të Shenjtë, abatin Ivan Pastric (Giovanni Pastrizio)<sup>20</sup> nga Spliti i Kroacisë, të cilit ai i dërgon dy letra nga

<sup>17</sup> Gaetano Moroni, *Dizionario di erudizione storico-ecclesiastica da s. Pietro sino ai nostri giorni* (Venezia: Tipografia Emiliana, 1840), vol. I, 183; E. Sedaj, *Papa shqiptar Klementi XI...*, 45.

<sup>18</sup> *Statistica con cenni storici della gerarchia e dei fedeli di rito orientale* (Città del Vaticano: Tipografia Poliglotta Vaticana, 1932), 12.

<sup>19</sup> Nën kujdesin e Albert Ramajt është botuar relacioni i Vinçenc Zmajeviqit i përkthyer në vitin 1988 nga Injac Zamputti dhe i transkriptuar nga Peter Bartl bashkë me shënimet e bëra prej tyre dhe është pajisur me artikuj. Vinzenz Zmajević, "Notizie universali dello stato di Albania e dell'operato da mons. Vincenzo Zmajevich Arcivescovo di Antivari Visitatore Apostolico dell'Albania", *Quellen und Materialien zur Albanesische Geschichte*, ed. Peter Bartl, vol. II (München: Rudolf Trofenik, 1979).

<sup>20</sup> *Notizie storiche degli Arcadi morti*, vol. II (Roma: Antonio de Rossi, 1720), 146-153. Libër që i dedikohet Girolamo Crispit, Auditore della Sacra Ruota Romana, Biografia e Giovanni Pastrizio-s është shkruar nga Alcandro Condileo. Giovanni Pastrizio jepte lëndën e teologjisë dogmatike dhe elokuencës. Ishte njohës i gjuhëve latine, ebraike, greke dhe arabe. Gjithashtu, ai ishte drejtor dhe redaktor i librave të historisë kishtarë dhe sekretar i Akademisë së Koncileve. S. Ljubich, *Dizionario degli uomini illustri della Dalmazia...*, 140-141.

Venecia.<sup>21</sup> Në letrën e 27 nëntorit 1700, ai shkruan se abati kroat ishte një nga miqtë e ngushtë të Klementit XI dhe i shpreh atij kënaqësinë për zgjedhjen e Papë Gianfrancesco Albanit - Klementit XI.<sup>22</sup> Në fakt, Giovanni Ciampini, Pastric dhe Albani kishin themeluar në vitin 1671 Akademinë e Koncileve pranë Propagandës Fide dhe kishin akumuluar një përvojë disavjeçare në organizimin e kuvendeve.<sup>23</sup> Kështu, për përgatitjen e Kuvendit të Arbrit, Zmajeviqi ishte mbështetur mbi traktate që profesori i tij kishte shkruar lidhur me këtë argument.<sup>24</sup> Gjithashtu, një pjesë të formimit dhe studimeve, abati kroat i kishte kryer në Kolegjin grek të Shën Atanasit në Romë, ku duhet të ketë pasur kontakte me arbëreshë e shqiptarë dhe kishte pasur si profesor Leone Allacci-n, veprat e të cilit i kishte redaktuar dhe i kishte përdorur për mësimdhënie në Kolegjin Urban.<sup>25</sup> Të dy gjithashtu kishin drejtuar Tipografinë Shumëgjuhëshe.<sup>26</sup>

Zmajeviqi kishte marrëdhënie edhe me françeskanin venecian Giuseppe Tommaso Studendoli, profesor i teologjisë në Kolegjin Urban. Ai i drejtohet gjithashtu edhe sekretarit të Propagandës Fide jezuitit Carlo Augusto Fabroni (1696-1706) me letrën e 1 gushtit 1702, i cili kishte pasur marrëdhënie të ngushta me Gianfrancesco Albanin që në vitin 1687, kur ishte sekretar i letrave papnore (*Segretario per le Brevi*) për t'u bërë më pas bashkëpunëtor dhe krahu i djathtë i tij pas vitit 1706, kur ai e ngriti në rangun e kardinalit.<sup>27</sup>

<sup>21</sup> Sinan Gashi, *Shqiptarësia e Vincentius Zmajevichu-t* (Prishtinë: 2011), 3.

<sup>22</sup> Në tekstin original thuhet: “*Mi rallegra l’elezione dell’Eccellentissimo Albani in Sommo Pontefice, sapendo quanto sia suo amico*”, që mund të përkthehet: “Gëzohem për zgjedhjen e Shkëlqësisë së tij Papë Albanit, duke patur parasysh sesa miqësi ka ai me ju”. P. Bartl, “Zur Biographie Vincenz Zmajevich...”, vol. I, dok. nr. 4, f. 33.

<sup>23</sup> Ivan Golub, “Život i djelo Ivana Paštrića”, *Crkva u svijetu Prinosi*, vol. XXIII, nr. 3 (Split: 1988), 228.

<sup>24</sup> *Aus dem Briefwechsel...*, vol. I, dok. 18. Letërkëmbimi i Zmajeviqit me Pastric-in, Perast, më 10 korrik 1703, 49; Vingenc Malaj, *Kuvendi i Arbënit – 1703* (Prishtinë: Instituti i Filozofisë-Sociologjisë, 1998), 94.

<sup>25</sup> Tomislav Mrkonjić, “Giovanni Patrizio”, në *Dizionario bibliografico degli italiani*, vol. LXXXI (Roma: Istituto della Enciclopedia Italiana di Storia “Giovanni Treccani”), 2014.

<sup>26</sup> G. Pizzorusso, “I Satelliti della Propaganda Fide...”, 491.

<sup>27</sup> Pietro Messina, “Carlo Agostino Fabroni”, në *Dizionario Bibliografico degli italiani*, vol. XLIV (Roma: Istituto della Enciclopedia Italiana di Storia “Giovanni Treccani”, 1994), 12. Fabroni mori pjesë aktive sidomos në polemikën që pati Papa Klementi XI me jansenistët.

Vinçenc Zmajeviqi e kishte rezidencën e tij në Perast të Bokës së Kotorrit, një udhëkryq ku kalonin jo vetëm rrugët tregtare që lidhnin Shqipërinë me Venecien, por edhe të misionarëve të Kongregacionit të Propagandës Fide me këtë destinacion. Nga qyteti i Kotorrit vinte edhe familja Bolizza, roli i së cilës ishte i rëndësishëm për Shqipërinë. Venecia i kishte besuar familjes Bolizza në vitet 1578-1786 shërbimin postar për letërkëmbimin (*i dispacci*) ndërmjet Venecies dhe Stambollit, rrugë e cila kalonte mes Alpeve shqiptare dhe Kosovës dhe më pas Francesco Bolizza ndërmori edhe shërbimin postar për letërkëmbimin e Propagandës Fide me misionarët.<sup>28</sup> Disa anëtarë të familjes si Francesco e Giovanni Antonio Bolizza kishin një rol politiko-diplomatik për sa u përket aleancave të zonave të Malit të Zi dhe të Alpeve shqiptare me Venecien, dhe ishin mbështetës të Urdhrit Françeskan në Shqipëri.<sup>29</sup> Kështu, marrëdhëniet ndërmjet familjeve Bolizza e Zmajeviq ishin të hershme në Kotorr që në periudhën e argjipeskëvit Andrea Zmajeviq. Për më tepër, familja Bolizza kishte origjinë shqiptare dhe kishte lidhje fafësnore me familjen nga Peja e Kosovës Begolli Hodaverdi.<sup>30</sup> Kështu, Giovanni Bolizza mbante një letërkëmbim të rregullt me Mahmut Begolli Hodaverdin, i cili ishte zgjedhur pasha i sanxhakut të Shkodrës, çka ndikoi pozitivisht në marrëdhëniet dypalëshe.\*

Kjo ishte në dobi të zonave të kufirit ndërmjet provincave veneciane nën juridiksionin e Kotorrit dhe Shqipërisë e Kosovës, sepse po ndiqej politika e tryezës së bisedimeve dhe parandalimit të konflikteve që i shkonte për shtat Venecies. Gjatë luftës së parë të Moresë (1664-1699), Venecia kishte krijuar një aleancë me Malin e Zi dhe Kuçin, Piprin e Palabardhin. Giovanni Bolizza kryente edhe misione diplomatike si ndërmjetës për reduktimin e taksave të Palabardhit dhe Zhupës, zonë pranë Kotorrit venecian, sepse ishte lajmëruar nga Hodaverdi se në

<sup>28</sup> Antal Molnár, "A forgotten bridgehead between Rome, Venice, and the Ottoman Empire: Cattaro and the Balkan missions in the Sixteenth and Seventeenth Centuries", *Hungarian Historical Review*, nr. 3 (2014), 494-528, 494, 500, 503.

<sup>29</sup> *Po aty*, 519-520.

<sup>30</sup> *Il Montenegro da relazioni di provveditori veneti dall' anno 1687 fino all' anno 1735*, ed. Ferdinando Ongania, Roma (Venezia: Emiliana, 1896), 28 korrik dhe 14 gusht 1702, 116-117.

\* Në letërkëmbim, Hodaverdi i drejtohet Bolizzës me fjalët "kushëriri dhe miku im".

vjeshtën e vitit 1702 në përmbushje të urdhërit sulltanor, po përgatitej një fushatë ushtarake për mbledhjen e taksave.<sup>31</sup>

Pikërisht, në këtë periudhë Papë Klementi XI - Albani, i interesuar për gjendjen e kishave e besimtarëve katolikë në Shqipëri dhe përhapjen e gjuhës shqipe, e dërgoi Vinçenc Zmajeviqin me mision si vizitator apostolik në Shqipëri më 22 shtator 1702.<sup>32</sup> Për këtë na informon Giovanni Bolizza në një letër që i dërgonte Proveditorit të Jashtëzakonshëm venecian të Kotorrit, ku i shkruante se ishin nisur së bashku me argjipeshkvin e Tivarit.<sup>33</sup> Në fakt, Zmajeviqi duke pasur parasysh rolin ndërmjetësues të Bolizzës, i cili kishte qenë edhe më parë në Shqipëri për t'u takuar me Hodaverdin, e ftoi atë që ta shoqëronte për të qenë më i sigurt. Bolizza përshkruan pritjen e tyre në Shkodër, takimin dhe mbështetjen e Hodaverdit kur i shpjegoi qëllimin e vizitës së Zmajeviqit në Shqipëri:<sup>34</sup>

“...sepse duke qenë se ishte ngarkuar për të vizituar dhe parë gjendjen e Ipeshkëve dhe besimtarëve në Shqipëri, këtë nuk mund ta kryente pa lejen dhe ndihmën e tij.”

Në fakt, vizita apostolike e tij në Shqipërinë e Veriut, në atë të Mesme, në Kosovë dhe Maqedoni do t'i paraprinte kuvendit që njihet si Kuvendi i Arbrit.<sup>35</sup>

Roli i Hodaverdit që i rëndësishëm për mbajtjen e Kuvendit të Arbrit në vitin 1703.<sup>36</sup> Autoriteti i sundimtarit të Shkodrës kishte peshën më të madhe në Shqipëri dhe përfshinte edhe atë të Ohrit e të Vlorës, prandaj

<sup>31</sup> *Il Montenegro da relazioni di provveditori...*, 28 korrik 1702, 14 gusht 1702, 15 tetor 1702, 116-117.

<sup>32</sup> E. Zenelaj, *Gjenealogjia e familjes shqiptare Albani...*, 146-147.

<sup>33</sup> *Il Montenegro da relazioni di provveditori...*, 15 tetor 1702, 117.

<sup>34</sup> “...perchè essendo stato incaricato di far visita per vedere come si diportavano li Vescovi e religiosi in Albania, questa non poteva praticare senza la sua permissione, et assistenza.” *Po aty*.

<sup>35</sup> V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 7.

<sup>36</sup> Peter Bartl, “Kryeipeshkvi Vinçenc Zmajeviq dhe thirrja e Kuvendit të Arbënit më 1703”, në Vincenzo Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë e Serbisë – Relazione dello Stato d’Albania e Serbia (1702-1703)*, ed. Albert Ramaj, Peter Bartl, Injac Zamputti (St. Gallen: Albanisches Institut, Prishtinë: Faik Konica, 2022), 356-357; P. Bartl, “Zur Biographie Vincenz Zmajevich...”, vol. I, 11.

kishte miratimin dhe mbështetjen e autoriteteve shqiptare të zonave ku shtrihej katolicizmi në Shqipërinë Veriqendrore dhe më gjerë.<sup>37</sup>

Kuvendi i Arbrit u thirr nga Papë Klementi XI si kuvend kombëtar (*Primo Concilio Nazionale Albanese detto Concilio Albani*), prandaj këtu do të trajtoheshin jo vetëm çështje fetare por edhe civile, dhe dekretet e tij për kishën katolike do të shtriheshin në mbarë Shqipërinë. Për mbajtjen e kuvendit, Vinçenc Zmajeviqi pati konsensusin e katolikëve dhe të myslimanëve shqiptarë.<sup>38</sup> Ja si shprehet Zmajeviqi lidhur me këtë:<sup>39</sup>

“Edhe prej atyre që janë ndër qytete jashtë banimit të katolikëve, të cilët, me të dërguar të posaçëm e me mënyra shumë të sjellshme, e ftonin të vizitonte edhe ata”.

Sundimtarët shqiptarë nuk po ndiqnin politikën e Stambollit që ishte për dëbimin e misionarëve.<sup>40</sup> Përkundrazi, Zmajeviqi u prit në mënyrë solemne nga Hodaverdi, djali i tij dhe paria e qytetit të Shkodrës:<sup>41</sup>

“Kur mori vesh arrijten e vizitorit në Shkodër, nisi Shator Pashën, të parin e oborrit, për ta përshëndetur dhe për ta sjellë pranë ushtrisë kalorësin në fjalë. Gjysëm dite larg nga lëmi i ushtrisë së tij, dërgoi të birin, çun 14 vjeçar, me dhjetë zotër kryesorë. Në largësi të një milje bëri të avanconin me kuajt e tyre të gjithë burrat kryesorë të ushtrisë, dhe ishin tetëdhjetë, për t'i dalë para, kurse ai vetë, si doli nga shatorrja e vet nën tingujt e

<sup>37</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 28; V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 8.

<sup>38</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 35; V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 13, 15.

<sup>39</sup> “*Anche delle citta' esistente fuori dell'habitato da Cattolici, che con inviati espressi, e con modi obliganti invitano a visitare anche loro*”. Po aty.

<sup>40</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 27-28; V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 9.

<sup>41</sup> Po aty; “*Intese egli l'arrivo del Visitatore à Scutari spedì il suo Sciattor Bassà primo della corte per complire, et accompagnarlo all'accennato Caualiere nell'esercito. Mezza giornata distante dal suo campo mandò il figliuolo, chè in età di 14 anni con dieci principali Signori. In lontananza d'un miglio auanzò tutti i principali soggetti dell'esercito à cavallo in numero d'ottanta per incontrarlo, et egli stesso uscito fuori del proprio padiglione à suon di trombe, piffari, e tamburri, et à sbarro di due cannoni di campagna lo accolse con mirabile cortesia tra affettuosi abbracciamenti...*”. *Il Montenegro da relazioni di provveditori...*, 18 tetor 1702, 117.

burive, pifarëve (surleve?) dhe trumbetave dhe me zbrazjen e dy topave fushorë, e priti me sjellje shumë të admirueshme në mes përqaftimesh dashamirëse...”

Gjatë vizitës së tij, argjipeshkvi i Tivarit u përcoll nga Giovanni Bolizza, së bashku me dy etër françeskanë, pjesë e enturazhit të tij: Raimondo Gallanin, sekretarin e tij dhe Egidio Quinto d'Armento (d'Armenia), prefekt i misionit françeskan në Shqipëri,<sup>\*</sup> i cili e njihte mirë vendin dhe gjuhën, dy bashkudhëtarë e disa vendës si dhe nga Shatir Bashi e rojet e tij.<sup>42</sup> Gjithashtu, ishte njoftuar paria shqiptare që gjatë rrugëtimit nga njëra krahinë në tjetrën, ai të përcillej nga udhërrëfyes të armatosur vendës.<sup>43</sup> Në fakt, vizita e Zmajeviqit zgjati tre muaj, megjithëse ai shkruan se qëndroi në Shqipëri për pesë muaj.<sup>44</sup> Për vizitën nuk pati shpenzime, megjithëse në qershor të vitit 1702 iu dhanë nga Kongregacioni i Shenjtë 200 skudë për t'i mbuluar ato, por për organizimin e Kuvendit të Arbrit dhe përkthimin e botimit të dekretëve, ai shpenzoi 2 000 dukate veneciane nga të ardhurat e tij.<sup>45</sup>

Në përfundim të saj, ai i propozoi gjithashtu Klementit XI mbajtjen e një kuvendi mbarëkombëtar nën kujdesin e të cilit u organizua pjesëmarrja.<sup>46</sup> Pas mbledhjes së kuvendit, Zmajeviqi përgatiti një relacion dhe ua drejtoi Propagandës Fide dhe Papë Klementit XI në mënyrë që të njihej situata e kishës në Shqipëri.<sup>47</sup> Në relacionin e vizitës së tij,

\* Përgatitja e materialeve të kuvendit në shqip ndoshta i vlejti atij për t'u ngjitur në hierarkinë kishtare si ipeshkëv i Sapës në vitin 1707 dhe i Tivarit në vitet 1719-1722 nga Papa Klementi XI.

<sup>42</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 30; V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 10-11; *Concili Provintiaali o Kuvendi i Arbënit*, botim kritik i Bardhyl Demirajt (Shkodër: Botime Françeskane, 2012), 12.

<sup>43</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 30; V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 10; Antun Bašić (Antonio Bassich), *Notizie della vita e degli scritti di tre illustri Perastini*, (Ragusa: Antonio Martecchini, 1833), 9.

<sup>44</sup> *Po aty*.

<sup>45</sup> *Aus dem Briefwechsel*, vol. I, dok. 15, 23 shtator 1703, 46; dok. 18, 10 korrik 1703, 49.

<sup>46</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 35; V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 13-14.

<sup>47</sup> *Po aty*; A. Bassich, *Notizie della vita...*, 7-8; *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë...*, vol. I, 15, 28. Pas vizitave apostolike të ipeshkvijve të Tivarit, Shkodrës, Durrësit, Lezhës, Sapës etj., ata i drejtonin relacione Propagandës Fide, të cilat janë mbledhur

Zmajeviqi jep të dhëna historike, gjeografike, demografike, fetare, ekonomike, sociale, kulturore etj.

Sipas letërkëmbimit, nga mesi i vitit 1703, ai e kishte përgatitur relacionin së bashku me dekretet e Kuvendit të Arbrit në versionin latinisht, autori i të cilit ishte ai vetë dhe tekstit në shqip, dhe e kishte pajisur me një hartë që e kishte krijuar për zonat që kishte vizituar.<sup>48</sup> Propaganda Fide drejtohej nga një kardinal - prefekt dhe një sekretar, të cilit zakonisht i drejtoheshin relacionet e vizitave apostolike.<sup>49</sup> Relacioni i argjipeshkvit perastin të Tivarit iu dërgua asokohe Fabronit me anë të atë Alberto da Bologna-s dhe u diskutua e u botua nga Propaganda Fide në periudhën dhjetor 1703 - shkurt 1704.<sup>50</sup>

Vinçenc Zmajeviqi ndoqi shembullin e ungjit të tij Andrea, i cili kishte mbajtur një kuvend në kishën e Shën Teklës në Spicë, më 10 dhjetor 1674.<sup>51</sup> Mangësitë me të cilat u përball gjatë vizitës së tij, e shtynë atë që të ndërmerre thirrjen e kuvendit dhe të dërgonte nga Kurbini me vulën e Raimondo Gallani-t, sekretarit të tij, ftesën e 2 dhjetorit të vitit 1702 drejtuar ipeshkvijve shqiptarë për pjesëmarrje në Kuvendin e Arbrit, të cilët më pas do ta përhapnin lajmin në të gjitha kishat sufragane.<sup>52</sup>

Siç vërehet në letërkëmbimin ndërmjet Zmajeviqit dhe Fabronit, synimi i kuvendit ishte përmirësimi i situatës kishtare në Shqipëri.<sup>53</sup>

dhe botuar në disa vëllime nga Injac Zamputi. Peter Bartl, "Die Diöcese Alessio Während der Türkenzeit im Spiegel der Geistlichen Visitationsberichte", në *Krishtërimi ndër shqiptarë*, Simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, ed. Dom Nikë Ukgjini, Willy Kamsi, Romeo Gurakuqi, (Shkodër: Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, 2000), 236. Sipas Bartl-it relacionet e vizitave apostolike janë të ngjashme. Ato japin në fillim të dhëna lidhur me kufijtë e dioqezave për të përcaktuar juridiksionin mbi kishat, përkrahje të vendeve të vizituara dhe distancave ndërmjet tyre, gjendjen e kishave, famullive, rregulltarëve, të ardhurat dhe subvencionet, numrin e shtëpive dhe të popullsisë në përgjithësi ose sipas besimit, shkeljet e së drejtës kanonike, abuzimet e nevojat e komunitetit dhe zgjidhjet. Në fakt, Propaganda Fide subvenciononte misionarët, restaurimin e kishave dhe pajisjet e tyre.

<sup>48</sup> *Aus dem Briefwechsel...*, vol. I, dok. 20, 12 korrik 1703, 51.

<sup>49</sup> P. Guilday, "The Sacred Congregation...", 483-485.

<sup>50</sup> *Aus dem Briefwechsel...*, vol. I, dok. 27, 7 janar 1704, 56, 11; E Sedaj, *Papa shqiptar Klementi XI...*, 46.

<sup>51</sup> J. Vrankić, "Aktiviteti misionar në Shqipëri...", 78; Daniele Farlati & Jacopo Coleti, *Illyrici Sacri*, vol. VII (Venezia: Sebastiano Coleti, 1817), 133-138.

<sup>52</sup> V. Zmajević, "Notizie universali dello stato di Albania...", vol. II, 13.

<sup>53</sup> *Aus dem Briefwechsel...*, vol. I, dok. 19, Perast: 12 korrik 1703, 50.

“Po ju rekomandoj nevojat e Shqipërisë, që meriton çdo lloj gjendje më të mirë se kjo në të cilën ndodhet për shkak të padijes së klerit”.<sup>54</sup>

Kuvendi i Arbrit u mbajt më 14-16 janar 1703 në Mërçinjë të Lezhës me pjesëmarrjen e argjipeshkvijve të Tivarit, Durrësit dhe Shkupit, ipeshkvijve të Sapës, Lezhës, Shkodrës, Pultit dhe prefektit të Përgjithshëm françeskan të Shqipërisë, prefektit françeskan për Shqipërinë e Mesme dhe provincialit të etërve françeskanë dhe rreth 43 rregulltarëve dhe 200 pjesëmarrësve.<sup>55</sup> Këtu u shpallën dekretet ose statutet e Kishës Katolike Shqiptare, që iu dërguan Papë Klementit XI «*Atit T'arbenit*» dhe u miratuan nga Propaganda Fide më 28 janar 1704.<sup>56</sup>

Qëllimi i kuvendit ishte parandalimi i mohimit të fesë katolike dhe konvertimit në atë myslimane dhe të kriptokrishterimit ose sinkretizmit fetar.<sup>57</sup> Përmirësimi i mangësive në aspektin fetar shprehej në ruajtjen e identitetit të besimit fetar dhe kombëtar që përfshinte edhe ruajtjen e kulturës dhe gjuhës shqipe.<sup>58</sup>

Dekretet e Kuvendit të Arbrit shtjellohen në 4 pjesë dhe 37 kapituj dhe trajtojnë: fenë dhe ushtrimin e saj (parandalimi i konvertimit nga feja katolike në atë myslimane për shkak të taksave dhe i fenomenit të kriptokrishterimit ose laramanizmit, katekizmi, predikimi, festat fetare, agjërimi i kreshmëve dhe betimi i rremë); sakramentet (ku bëjnë pjesë pagëzimi, krezmimi ose konfirmimi, rrëfimi, kungimi, vajimi, urdhri i shenjtë ose shugurimi i priftërinjve dhe martesat); kleri (ipeshkvijt, priftërinjtë dhe misionarët, kufijtë ndërmjet argjipeshkvive dhe juridiksioni kishtar, të ardhurat e famullitarëve); kishat (altarët, mesha,

<sup>54</sup> *Raccomando li bisogni d'Albania, che merita ogn'altro miglior stato di quello, nel quale presentemente si trova per la molta ignoranza del clero'. Po aty.*

<sup>55</sup> *Concili Provintiaali o Kuvendi i Arbnit...*, 86.

<sup>56</sup> V. Malaj, *Kuvendi i Arbënit...*, 96.

<sup>57</sup> Noel Malcolm, *Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit* (Prishtinë: Botime Artini, 2020), 149-150. Kriptokrishterimi ishte një formë e jetës së disa komuniteteve, ku ndërthureshin islami dhe krishterimi, sepse individët konvertoheshin në fenë islame dhe paraqiteshin me emra myslimanë në jetën sociale, por ruanin bazat e besimit të krishterë dhe merrnin sakramentet.

<sup>58</sup> E. Sedaj, *Papa shqiptar Klementi XI...*, 7, 52.

objektet e kultit, varrezat); shkollat (Kolegji Urban i Propagandës Fide, shkolla e Kurbinit dhe e Lezhës).<sup>59</sup>

Në kuvend u vendos gjithashtu që doktrina fetare të mësohej në shqip «*Doktrinat e Bellarminit sctampuem schipp*», duke u mbështetur në përkthimin e Pjetër Budit, ipeshkvit të Sapës, të librit të shkruar nga kardinal Roberto Bellarmino, *Dottrina cristiana - Doktrina e Kërshtenë* që ishte botuar në Romë më 1618 nga Bartolomeo Zanetti dhe ribotuar më 1664 nga Propaganda Fide.<sup>60</sup>

Gjithashtu, arsimimi në gjuhën shqipe në disa shkolla të krishtera në Shqipëri që kishte nisur që me hapjen e tyre në shek. XVII dhe vazhdonte në shkollën e Kurbinit (1632) dhe të Velës së Lezhës, ishte një nga pikat e kuvendit.<sup>61</sup> Në relacionin e Zmajeviqit flitet për lindjen e shkollës së Lezhës, e cila ishte hapur në Velë sipas testamentit dhe aktdhurimit të vitit 1688 të Gjergj Vlladanjit,<sup>62</sup> ipeshkvit të Lezhës, i cili i kishte lënë 250 dukate veneciane Andrea Zmajeviqit, argjipeshkvit të mëparshëm të Tivarit që të plotësonte vullnetin e tij.<sup>63</sup>

<sup>59</sup> *Po aty*, 57-60; P. Vrankić, “Aktiviteti misionar në Shqipëri...”, 80-84; S. Reboulet, *Histoire de Clement XI...*, 106-107; Për një përmbledhje të dekreteve të Kuvendit të Arbrit, shih: V. Malaj, *Kuvendi i Arbënit...*, 113-127; D. V. Giordani, “Albania (Concilio provinciale e nazionale di, o Albanese)”, Pietro Pianton, *Enciclopedia ecclesiastica*, vol. VIII (Venezia: Gerolamo Tasso, 1864), 127-129; Shan Zefi, *Kuvendi i parë i Arbërit*, qershor 2022. <https://www.misioni-aarau.ch> (shikuar më 29 shtator 2022).

<sup>60</sup> *Concili Provintiaali o Kuvendi i Arbenit...*, 27. Pjesa e parë, kreu i pestë; Bardhyl Demiraj, “Aktet e “Kuvendit të Arbënit” dhe rëndësia e tyre”, në *Kuvendi i Arbënit 1703*, ed. Zef Gashi, Konferencë me rastin e 300-vjetorit të mbajtjes së Kuvendit të Arbrit (Prishtinë: Shpresa, 2003), 74; V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 143.

<sup>61</sup> B. Demiraj, “Aktet e “Kuvendit të Arbënit...”, 75.

<sup>62</sup> *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore (1634-1650)*, vol. II, dok. 65, f. 346-349 dhe dok. 98, f. 417, 480. Gjergj Vlladani vinte nga një përvojë e mirë si profesor i filozofisë në Paris në vitin 1647 dhe mësues privat i bijve të familjes Barberini, që i kishte dhënë Selisë së Shenjtë Papë Maffeo Vincenzo Barberin-in, Urbanin VIII (1623-1644).

<sup>63</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë*, 111; V. Zmajević, “Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 91-92; P. Bartel, “Die Diöcese Alessio”..., 243. “...che tutto il denaro, et altro delle mie prouisioni, che si trova nelle mani del Monsignor Archiuescovo d’Antivari Andrea Zmajeuich sia impiegato in tante possessioni, che seruano per mantenere uno, o’ due maestri, che uno insegni la grammatica, e l’altro i casi di coscienza nella Diocesi d’Alesio. Item tutte le possessioni che io ho’comprato sia applicate, et impiegate per li medesimi maestri.”

“Të gjitha të hollat dhe të tjera nga provizionet e mia, që gjenden në duart e imzot kryepeshkopit të Tivarit, Andrea Zmajeviqit, po i lë që të futen në punë për të blerë prona tokësore që të shërbejnë për të mbajtur një ose dy mësues, njëri prej të cilëve të mësojë gramatikën dhe tjetri çështjet e ndërgjegjes, në dioqezën e Lezhës. Gjithashtu të gjitha pronat tokësore që unë kam blerë të caktohen e të futen në punë po për ata mësues.”

Ai i kishte investuar këto para si vakëf monetar, me një interes prej 7% që përkonin me një subvencion prej 15 dukatesh veneciane për çdo mësues.<sup>64</sup>

Me shembullin e argjipeshkvit Gjergj Vlladanji, disa tregtarë të Shkodrës përfshirë edhe nipin e tij, Simon Vlladanji, vëllanë e Kolë Vlladanjit më pas ipeshkëv i Lezhës dhe Gjon e Anton Kolës si dhe disa banorëve të Shirokës, që Zmajeviqi e konsideronte megjithëse në rrethinat e Shkodrës si një nga lagjet periferike të saj, donin të hapnin një shkollë në Shirokë dhe për këtë i ishin lutur atij që t’i kërkonte Propagandës Fide një misionar për mësimdhënie, i cili së bashku me një mësues laik do të mbaheshin me shpenzimet e të krishterëve.<sup>65</sup> Shkolla do të shërbente edhe për arsimimin e klerit. Ja si shprehet ai:<sup>66</sup>

“Këta dhe të tjerë të famullisë, luten t’u shënohet një atë misionar për të qenë mësues shkolle në Shirokë, me një lajko (sic) [laik] për shok, dhe këta do të mbahen me shpenzimet e të krishterëve në një shtëpi më vete”.

Aspiratat për përhapjen e arsimit në saje të Propagandës Fide për shkollat në Shqipëri, arritën kulmin me kontributin e Papë Albanit. Në vitin 1707, Klementi XI ngriti Kolegjin françeskan të San Bartolomeo all’Isola dhe mësimdhënia e shqipes iu la në vitin 1709 Francesco Maria

<sup>64</sup> Eduart Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane* (Tiranë: Instituti i Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021), 98-106.

<sup>65</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 54; V. Zmajevič, ”Notizie universali dello stato di Albania...”, vol. II, 34.

<sup>66</sup> “*Supplicano questi et altri della Parochia la deputazione d’un P. missionario per Maestro Di Scuola a’ Scirocco con un Laico compagno, che saranno mantenuti alle spese de Christiani in Casa separata*”. Po aty.

da Lecces.<sup>67</sup> Nën kujdesin e Papë Klementit XI u botua gramatika e parë shqipe e hartuar pikërisht nga Francesco Maria da Lecce, asokohe prefekt françeskan i Shqipërisë së Mesme (Maqedonisë) me vendbanim në kuvendin e Gurëzit dhe mësues në shkollën e Pllanës në zonën e Lezhës.<sup>68</sup> Po nga i njëjti autor, u përgatit një vit më pas më 1702 edhe fjalori italisht - shqip që nuk u botua për disa shekuj.<sup>69</sup>

Pas bulës papale *Commissi nobis* të 22 janarit të vitit 1711 të Klementit XI dhe kërkesës së Vinçenc Zmajeviqit, Propaganda Fide më 20 prill 1711 lejoi ngritjen e katedrës së gjuhës shqipe pranë kuvendit françeskan të San Pietro Montorios.<sup>70</sup> Këtu studioheshin veprat e para që kishin dokumentuar gjuhën shqipe dhe materialet e botuara pas Kuvendit të Arbrit.

Papë Klementi XI pati rolin kryesor për thirrjen e Kuvendit të Arbrit, ndërsa Vinçenc Zmajeviqi për organizimin dhe përgatitjen e tij, materialet e të cilit u botuan nga Propaganda Fide në latinisht dhe në shqip në vitin 1706 me titull: *Concili Provinciaali o Cuvendi i Arbenit mbledhune nde viett gnai mije sctat cint e tre. Ndene Clementit i Gnimidhietmi Pape Pretemadhit* (Romae, typis S. Congregatio de Propaganda Fide, anno MDCCVI).<sup>71</sup> Dekretet e kuvendit u përkthyen në shqip nga Egidio Quinto d'Armento dhe u redaktuan nga Francesco Maria da Lecce në vitet 1705-1706.<sup>72</sup>

Kuvendi i Arbrit ishte një vazhdim i dekreteve të mëparshme që i përkisnin kishës shqiptare dhe baza e së drejtës kanonike e dekreteve të mëvonshme që do të sanksionoheshin nga Prospero Lorenzo Lambertini,

<sup>67</sup> Otto Meyer, *Die Propaganda, ihre Provinzen und ihr Recht: mit besonderer Rücksicht auf Deutschland*, (Göttingen: Dieterichschen Buchhandlung, Leipzig: Christian M. Vogel, 1852), 184; F. Altimari, "La "rinascita" albanica...", 76.

<sup>68</sup> Francesco Maria da Lecce, *Osservazioni Grammaticali Nella Lingua Albanese* (Roma: Stamperia della Sag. Congregazione di Propaganda Fide), 1716; E. Zenelaj, *Gjenealogjia e familjes Albani...*, 137; V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 106; V. Zmajević, *Notizie universali dello stato di Albania...*, vol. II, 86-87.

<sup>69</sup> Francesco Maria da Lecce, *Dittionario italiano-albanese*, ed. Gëzim Gurga (Shkodër: Botime françeskane, 2009).

<sup>70</sup> Athanas Gegaj, "Mësimi i gjuhës shqipe në Romë në shek. XVIII-XIX", *Hylli i Dritës*, viti VII, nr. 4 (Shkodër: prill 1731), 218.

<sup>71</sup> S. Reboulet, *Histoire de Clement XI...*, 107; Lidhur me botimet shih: V. Malaj, *Kuvendi i Arbënit...*, 100-104; B. Demiraj, "Aktet e "Kuvendit të Arbënit"...", 72.

<sup>72</sup> V. Malaj, *Kuvendi i Arbënit...*, 97-99.

Papë Benedikti XIV në dy enciklikat e mëvonshme të viteve 1744-1754 dhe në Kuvendin e Dytë e të Tretë të Arbrit më 1871 dhe më 1895.<sup>73</sup> Rugën e Klementit XI e vazhdoi Benedikti XIV, i cili kishte qenë anëtar i Akademisë së Konkileve e sekretar i saj në vitin 1720 dhe dishepull i profesorit të tij, Ivan Pastric.<sup>74</sup>

Kuvendi i Arbrit pati një ribotim të plotë së bashku me enciklikat e Benediktit XIV (1740-1758) në vitin 1803 me rastin e 100-vjetorit të mbajtjes së tij.<sup>75</sup> Për rëndësinë që pati pikërisht ky version u shqipërua në vitin 1868 dhe u botua në të dyja gjuhët edhe në vitin 1872 nga Engjëll Radoja me kërkesë të argjipeshkvit të Tivarit Karl Pootens me titull: *Concilli i dhëut Scciypniis baamun n'viet 1703 v'coh T'Paps Scgyptarit Clementit T'Gnimdhettit*, Roma, Propaganda Fidae, 1872. Teksti në shqip është botuar pjesërisht si shtojcë e librit të studjuesit kosovar Engjëll Sedaj.<sup>76</sup>

Me rastin e 300-vjetorit të mbledhjes së Kuvendit të Arbrit, në vitin 2003 nën kujdesin e argjipeshkvit të Tivarit Zef Gashi, u botua versioni në latinisht, dy versionet në shqip dhe një version në shqipen e sotme i përshtatur nga Anton Nikë Berisha.<sup>77</sup> Origjinali i Kuvendit të Arbrit u botua si shtesë e një studimi nga Eqrem Zenelaj.<sup>78</sup> Së fundi, vendimet e Kuvendit të Arbrit u botuan në vitin 2012 përbri origjinalit nën kujdesin e Bardhyl Demirajt.<sup>79</sup>

<sup>73</sup> Bardhyl Demiraj, “Enciklika ‘Inter Omnigenas’ (2 shkurt 1744) - rrethanat e përfitimt dhe ndikimi i saj në arealin kulturor shqiptar të Veriut”, *Shejzat*, 1-2, (2016), 95. Dy enciklikat: *Inter-Omnigenas (2 shkurt 1744)* dhe *Quod provintiale (1 gusht 1751)* kishin si qëllim rregullimin e jetës kishtarë shqiptare.

<sup>74</sup> Maria Pia Donato, “Le due accademie dei concili a Roma”, në *Naples, Rome, Florence - Une histoire comparée des milieux intellectuels italiens (XIII-XVIII siècles)*, ed. Jean Boutier, Brigitte Marin, Antonella Romano (Rome: École Française de Rome, 2005), 249-250.

<sup>75</sup> *Concilium provinciale sive nationale Albanum habitum anno MDCCIII. Clemente XI. Pontifex Maximus Albano, editio secunda. Posteriorum constitutionum apostolicarum ad Epiri Ecclesias spectantium appendice ditata*, (Romae: Typis. S. Congr. De Propaganda Fide, 1703).

<sup>76</sup> E. Sedaj, *Papa shqiptar Klementi XI.*, I-XXI.

<sup>77</sup> Petrit Nika, “Mons. Vinçenc Zmajević dhe Kuvendi i Arbënit, 1703”, në *Kuvendi i Arbënit 1703*, ed. Zef Gashi, Konferencë me rastin e 300-vjetorit të mbajtjes së Kuvendit të Arbrit (Prishtinë: Shpresa, 2003).

<sup>78</sup> Shih shtojcën tek: E. Zenelaj, *Gjenealogjia e familjes shqiptare Albani*.

<sup>79</sup> *Concili Provintiaali o Kuvendi i Arbnit ...*, botim kritik i Bardhyl Demirajt.

Karakteri patriotik i Kuvendit të Arbrit shfaqet në evokimin e tij me të njëjtin emër të njohur si Besëlidhja e Lezhës dhe zgjedhjes së vendit ku u mbledhën Gjergj Kastrioti Skënderbeu me princat arbër dhe kuvendin e mbajtur në Mat nga Pal Engjëlli më 8 nëntor 1462.<sup>80</sup>

Në ndryshim nga ortodoksët të cilëve u ishin njohur statusi i tyre si millet (komunitet) nga Perandoria Osmane nëpërmjet Patrikanës, që gjendej brenda kufijve të saj, për katolikët nuk egzistonte një marrëveshje e tillë, aq më tepër sepse Selia e Shenjtë gjendej jashtë kufijve të Perandorisë.<sup>81</sup> Lidhur me këtë, Zmajeviqi mendonte se njohja e statusit të katolikëve «*degl'antichi privilegij per l'Albania*» mund të arrihej me anë të ndërhyrjes së Propagandës Fide pranë ambasadorëve të shteteve të Europës Perëndimore në Stamboll.<sup>82</sup>

Më 1701, në rrethinat e Durrësit, banorët kishin vështirësi për të paguar taksat dhe argjipeshkvisë së Durrësit i ishte ndaluar tërheqja e të dhjetave nga pronat e saj.<sup>83</sup> Prania e konsullatës franceze dhe veneciane në Durrës, të cilat mbronin të drejtat e qytetarëve të tyre dhe interesat tregtarë, që u ishin njohur nga Perandoria Osmane, e cila i konsideronte ato si kombe (milege) kishte qenë e frytshme për sa i përket përkrahjes nga ana e tyre e argjipeshkvit të Durrësit Pjetër Zumi, njërit prej firmëtarëve të Kuvendit të Arbrit. Kështu, në kapërcyell të shek. XVII dhe në fillim të shek. XVIII, argjipeshkvi i Durrësit gjeti mbështetjen e konsullit venecian të këtushëm Pietro Roza dhe arriti me ndërmjetësimin e tij ta detyronte nga ana morale parinë e qytetit që t'i lejohej atij dhe rregulltarëve katolikë rikthimi në Durrës nga selia e Kurbinit.<sup>84</sup> Kjo për faktin se konsullatat e huaja në Durrës gëzonin respektin edhe të banorëve myslimanë dhe ortodoksë të qytetit.

Argjipeshkvi i Tivarit mbajti një qëndrim protektiv ndaj zonave ku taksat ishin të larta dhe, falë raporteve të mira me Hodaverdin, arriti heqjen e tyre për një vit për Grudën, Tejanin, Briskën dhe Livarin dhe për

<sup>80</sup> P. Vrankiç, "Aktiviteti misionar në Shqipëri...", 77.

<sup>81</sup> Natalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, përkth. Artan Puto (Tiranë: Përpjekja, 2009), 40, 52-53.

<sup>82</sup> *Aus dem Briefwechsel*, vol. I, dok. nr. 27, 7 janar 1704, 56; *Concili Provinciaali o Cunvendi i Arbnit...*, 108-109. Kjo rridhte nga pjesa 4, kreu 6 i kuvendit ku u vendos t'u dërgoheshin letra ambasadorëve në Stamboll për të ndërhyrë për mbrojtjen e statusit të besimtarëve katolikë.

<sup>83</sup> *Po aty*, dok. nr. 5, 9 gusht 1701, 35.

<sup>84</sup> D. Farlati dhe J. Coleti, 1817, vol. VII, 383.

11 familje të varfra të Tivarit që rrezikonin braktisjen e fesë katolike dhe taksën prej 1 dukati të satraçit (taksa e kuajve) për klerin e Tivarit dhe Sapës.<sup>85</sup> Studiuesi Arnold shkruan se shkaqet e konvertimit të krishterëve në besimin mysliman ishin sociale, politike dhe ekonomike. Duke u mbështetur te relacioni i Zmajeviqit, që flet në këtë rast për ndikimin e peshës së taksave, ai mendon që ato të mos kenë ndodhur nën presion, por edhe për shkaqe të tjera dhe kjo sipas tij mund të shpjegohet me faktin se, si prelatët ashtu dhe priftërinjtë respektoheshin nga autoritetet lokale.<sup>86</sup> Gjithashtu, ai vëren se është ndjenja kombëtare dhe përkatësia fisnore që i bashkon shqiptarët me gjithë përkatësinë në besime të ndryshme: myslimanë, ortodoksë dhe katolikë si dhe ndjekja e të njëjtave tradita.<sup>87</sup> Në fakt, Kuvendi i Arbrit ishte për ruajtjen e traditave dhe zakoneve shqiptare.<sup>88</sup>

Gjithashtu, roli i Vinçenc Zmajeviqit pati rëndësi edhe për sa u përket taksave të tjera që ishin vendosur nga Stambolli.<sup>89</sup> Ai kishte dërguar një përfaqësues në Stamboll me shpenzimet e veta për të ndërmjetësuar lirimin nga pesha e taksave.<sup>90</sup> Me sa duket nga letërkëmbimi, dekretet pas mbajtjes së kuvendit, ia kishin arritur përkohësisht qëllimit sepse për një vit nuk kishte pasur asnjë konvertim në fenë myslimane për shkak të taksave.<sup>91</sup>

Në përfundim të vizitës, ndër propozimet që Zmajeviqi i bënte Propagandës Fide ishin edhe hapja e një kolegji ose seminari për përgatitjen e klerit në Shqipëri, sepse seminaristët që përgatiteshin në Itali, nuk preferonin të ktheheshin në atdhe për t'iu shmangur një jete

<sup>85</sup> *Aus dem Briefwechsel...*, dok. nr. 18, Perast, 10 korrik 1703, 48-49 dhe dok. nr. 23, 15 tetor 1703, f. 53-54; V. Zmajević, "Notizie universali dello stato d'Albania", 9; Dritan Egro, "Islam in the Albanian Lands (XVth – XVIIIth)", *Religion und Kultur im albanisch-sprachigen Südeuropa*, ed. O. J. Schmitt. (Frankfurt: Peter Lang, 2010), 41. Në sistemin e taksave osmane kristianët dhe besimet e tjera jomyslimane duhej të paguanin taksën fikse të xhizjes për kokë dhe taksën e ispenxhes mbi bashtinën ose tokën.

<sup>86</sup> Thomas W. Arnold, *Historia e përhapjes së islamit: rrjedhat historike të misionit*, përkth. Nexhat Ibrahim, (Prishtinë: Dituria islame, 2004), 121-123.

<sup>87</sup> *Po aty*, 116-117.

<sup>88</sup> *Concili Provinciaali o Kuvendi i Arbnit...*, 17.

<sup>89</sup> D. Egro, "Islam in the Albanian Lands (XVth – XVIIIth)...", 33.

<sup>90</sup> *Aus dem Briefwechsel...*, vol. I, dok. nr. 26, f. 55.

<sup>91</sup> *Po aty*, dok. nr. 27, 7 janar 1704, 56.

angazhuese dhe me risqe.<sup>92</sup> Zmajeviqi kishte si prioritet ngritjen e një hospici (*ospizio*) si vendbanim të përkohshëm në Kotorr, ku mund të strehoheshin misionarët që shkonin drejt Shqipërisë të cilët mund të qëndronin edhe gjatë kthimit, dhe kërkonte që t'u caktohej një prift për t'i mësuar gjuhën shqipe para se të futeshin në Shqipëri.<sup>93</sup> Kjo ndoshta për faktin se ai i kishte hapur dyert e shtëpisë së tij në Perast për të pritur misionarët e Shqipërisë.<sup>94</sup>

Edhe Giovanni Bolizza kishte një projekt për ngritjen e një seminari në Kotorr për arsimimin e të rinjve shqiptarë dhe pikërisht është me interes testamenti i tij sepse për ta realizuar këtë, ai lë një shumë prej 500 dukatesh dhe shtëpinë e tij.<sup>95</sup> Në fakt, më 4 janar 1704, Klementi XI i drejtohet atij, megjithëse në një artikull thuhet se ai quhej Giuseppe Bolizza, me një letër ku e nderonte me bekimin apostolik sepse kishte shoqëruar në Shqipëri Vinçenc Zmajeviqin, argjipeshkvin e Tivarit dhe për ndihmesën që u kishte dhënë kristianëve nën pushtimin turk.<sup>96</sup>

Si përfundim, kuvendi pati rëndësi sipas Demirajt në aspektin historik sepse reflektoi një ngjarje me shumë peshë për Shqipërinë e shek. XVIII, në aspektin juridik ligjësoi një tekst normativ të së drejtës kishtare dhe në aspektin gjuhësor dokumentoi shkallën e zhvillimit të gjuhës shqipe në qerthullin e teksteve të vjetra.<sup>97</sup>

Rilindja Albani konsiderohet si një Rilindje e parë ose një Rilindje para Rilindjes dhe dëshmon për rolin që pati Papë Klementi XI si në rrafshin fetar ashtu dhe në atë kombëtar në dy dekadat e para të shek. XVIII për Shqipërinë dhe arbëreshët e shtrirjen e saj deri nga mesi i shek. XVIII.<sup>98</sup> Pikërisht, hapja e shkollave dhe studimi i teksteve në gjuhën amtare është një pikë konvergjence dhe filli që bashkon zgjimin

<sup>92</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 163; V. Zmajević, "Notizie universali dello stato d'Albania...", vol. II, 142; Th. W. Arnold, *Historia e përhapjes së islamit...*, 121.

<sup>93</sup> V. Zmajevich, *Relacion i gjendjes së Shqipërisë...*, 164; V. Zmajević, "Notizie universali dello stato d'Albania...", vol. II, 144.

<sup>94</sup> *Aus dem Briefwechsel...*, vol. I, dok. 22, Perast, 10 gusht 1703, 52-53.

<sup>95</sup> Rossana D'Alberton Vitale, "Descrizione del Sangiaccato di Scutari. Un devoto tributo letterario alla Serenissima da parte di un fedele suddito cattarino", në *Studi Veneziani*, n.s., vol. XLVI (Pisa: Roma: Istituti editoriali e poligrafici internazionali, 2003), 315.

<sup>96</sup> Po aty.

<sup>97</sup> *Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit*, 71-72.

<sup>98</sup> F. Altimari, "La "rinascita" albanica...", 68, 74.

kombëtar në shek. XVIII dhe Rilindjen, e cila mbështetet te shkrimi i gjuhës shqipe si thelbësor për kulturën e vetëdijën kombëtare dhe ngritjen kulturore si një mënyrë për të ndriçuar kombin.<sup>99</sup>

### ALVIN SARAÇI

Institute of History/ Academy of Albanological Studies, Tirana  
saracialvin@hotmail.com

#### *S u m m a r y*

RELIGION AND FATHERLAND IN KUVENDI I ARBRIT (THE ALBANIAN COUNCIL):  
THE CONTRIBUTE OF THE POPE CLEMENT XI ALBANI, THE PROPAGANDA FIDE  
AND VICKO ZMAJEVIĆ

The essay deals with the Albanian Council “Kuvendi i Arbrit” that was hold in 1703 and the contribute of the Pope of Albanian origin Clement XI, Albani (1700-1721) and Vinçenc or Vicko Zmajević for its organisation and the approval of the decrees for the Albanian Catholic Church and the Albanian question of spreading the light of wisdom and the Albanian language and culture by means of setting up schools. The Albanian edition of 1706 served as the basis of the canon law and as one of the ancient Albanian texts, that together with the first Albanian grammar was in use for the education in the colleges. The cultural and national awakening that preceded the Renaissance that begun by the Pope Clement XI went on with the Pope Clement XII, Corsini (1730-1740), who opened the Arberesh Colleges of San Benedetto Ullano of Cosenza and Palermo in Sicilia and the Pope Benedict XIV (1740-1758) who reconfirmed these decrees.

---

<sup>99</sup> Gjystina Cacaj – Shushka, *Ndihmesa e Naum P. Veqilharxhit në shqipërimin e Biblës* (Prishtinë: Rilindja, 1997), 15-19.